



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 16, Datë 16.01.2025

MBI

**PËRLLOGARITJEN E MBËSHTETJES FINANCIARE QË DUHET TË
DOKUMENTOJNË NË ERE SUBJEKTET QË APLIKOJNË PËR T'U PAJISUR ME
LICENCË PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT DHE/OSE
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 152 prot., datë 15.01.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi përlogaritjen e mbështetjes financiare, që duhet të dokumentojnë në ERE subjektet që aplikojnë për t’u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, ka miratuar “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me vendimin nr. 215/2019 dhe me vendimin nr. 220/2022.
- Në referencë të përcaktimeve të Rregullores, aplikuesit që kërkojnë të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike, në kuadër të dokumentimit të aftësisë financiare për ushtrimin e secilës prej këtyre veprimtarive, duhet të plotësojnë, ndër të tjera, dhe kërkesat e nenit 9, pika 1,3, gërma “b” të kësaj rregulloreje, duke depozituar dhe sa vijon:
Bilancin financiar i 3 (tri) viteve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), i audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion, etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (Në rastin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi).
- Për sa më sipër dhe me qëllim orientimin e drejtë të aplikuesve mbi referencat që duhet të merren për bazë në këtë përlogaritje, e cila do të bëhet duke u bazuar në të dhënat Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX sh.a., vlerësohet që neni 9, pika 1.3, gërma “b” i Rregullores të plotësohet më tej si vijon: *Në rastin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të*

aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi dhe përlogaritjes që do të bëhet duke marrë për bazë çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit.

- Ky përcaktim do të zbatohet për të gjitha aplikimet që do të paraqiten në ERE për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe atë të furnizimit të energjisë elektrike nga data 1 shkurt 2025.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ka kompetencën dhe të drejtën për të miratuar informacionet përkatëse që duhet të paraqiten bashkëlidhur çdo aplikimi për licencë, ashtu sikurse aplikuesit kanë detyrën të depozitojnë në ERE çdo dokument apo informacion që vlerësohet i nevojshëm në kuadër të pajisjes me licencën përkatëse.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Subjektet që aplikojnë në ERE për t’u pajisur me licencë për veprimtarinë e tregtimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike duhet të bëjnë përlogaritjet për mbështetjen financiare që i nevojitet për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 muaji të veprimtarisë duke u bazuar në çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit.
2. Ky përcaktim do të zbatohet për të gjitha aplikimet që do të paraqiten në ERE për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike nga data 1 shkurt 2025.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas Botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI